



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË  
KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMEVE**

**ANALIZË VJETORE PUNE  
JANAR – DHJETOR 2020**

Nisur nga misioni i tij Komiteti Shqiptar i Birësimeve gjatë këtij viti, pavarësisht kushteve jo të zakonta është përpjekur të zbatojë rigorozisht të gjitha detyrat që i ngarkohen si institucion në respekt të legjislacionit në fushën e birësimeve duke përmbushur kështu, objektivat e vendosura për këtë hark kohor, Janar- Dhjetor 2020.

Gjatë këtij viti është punuar intensivisht për disa ndryshime në Ligjin nr.9695, datë 19.03.2009 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”, i ndryshuar, për krijimin e një kuadri ligjor i cili do të përmbushë të gjitha kërkesat e një shërbimi cilësor, lehtësimin e procesit si dhe të nxisë deinstitutionalizimin e fëmijëve. Nëpërmjet këtij Ligji do të ndryshojnë disa nene në kuadrin e përmirësimit të infrastrukturës së shërbimit të birësimit.

Niveli i cilësisë së shërbimit është garantuar në kohë për çdo të interesuar, si nëpërmjet kontakteve të drejtëpërdrejta ashtu edhe on line. Gjithashtu është zhvilluar një veprimtari cilësore në aspektin e garantimit të interesit më të lartë për fëmijët e braktisur që kanë kaluar të gjitha fazat e nevojshme të procedurës së birësimit.

Nga ana e stafit të KSHB-së, janë zbatuar të gjitha detyrat në zbatim të përshkrimit të punës, legjislacionit dhe rregullores së brendshme. Ky organizim duke pasur në fokus punën e secilit specialist, bashkëpunimin, profesionalizmin dhe punën në grup, ka bërë që të finalizohet me sukses dhe në mënyrë të plotë çdo çështje që ka lidhje me birësimin.

Për t’u theksuar është fakti që gjatë këtij viti KSHB ka operuar me efikasitet të plotë në të gjitha drejtimitet e punës së tij dhe njëkohësisht ka shërbyer si një mekanizëm i rëndësishëm në bashkëveprim me institucionet e tjera të administratës qendrore dhe lokale për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe veçanërisht të të miturve që i nënshtrohen procedurës së birësimit vendas dhe ndërvendas.

Duke e përqëndruar analizën e punës së institucionit të Komitetit Shqiptar të Birësimeve për periudhën e sipërcituar, në detyrat dhe përgjegjësitë e çdo punonjësi të stafit rezulton :

**I. FUSHA JURIDIKE**

Gjatë harkut kohor **Janar - Dhjetor të vitit 2020**, juristi i KSHB-së në bashkëpunim me stafin e institucionit, ka ndjekur dhe evidentuar problematikën e paraqitur gjatë kësaj periudhe duke finalizuar brenda afateve të kërkuara të gjitha detyrat përkatëse sipas përshkrimit të punës.

NR.	AKTIVITETI / OBJEKTIVI	NIVELI I REALIZIMIT	RRUGËT E REALIZIMIT	PERSONI PËRGJEGJËS	KOHA E REALIZIMIT
1.	Ofrimi i konsulences ligjore	Realizuar	Përgjatë periudhës janar-dhjetor të këtij viti në vijim të mbarëvajtjes së detyrave të përcaktuara për pozicionin e punës së juristit të KSHB është vijuar me dhënien e shërbimit ligjor për të gjithë personat e interesuar pranë KSHB sipas kërkesave të tyre. Shërbimit ligjor duke qënë një ndër kërkesat prioritare, për të hyrë në procedurat e birësimit për të gjithë personat e interesuar pranë KSHB, ka konsistuar në dhënien e informacionit ligjor lidhur me çështjet e birësimit të fëmijëve brenda dhe jashtë vendit, njohja e tyre me politikën që ndjek Komiteti Shqiptar i Birësimeve me qëllim	Juristi, Stafi	Janar-Dhjetor 2020

			<p>përmbushjen e kritereve ligjore. Gjithashtu është asistuar dhe janë dhënë këshilla ligjore për plotësimin e dosjeve me mangësi, të paraqitura nga aplikantë për birësim, dhe për të gjitha problemet e parashtruara prej tyre apo personat të cilët i janë nënshtruar procedurave për birësimin e një fëmije brenda dhe jashtë vendit. Ofrimi i ndihmës juridike është dhënë edhe për çështje që kanë të bëjnë me "birësimin me pëlqim", apo personat që parashtrojnë këtë kërkesë.</p> <p>Sipas përcaktimeve në rregulloren e KSHB, pasi juristi i ka shqyrtuar me kujdes të gjitha rastet e paraqitura dhe ka verifikuar dokumentacionin e nevojshëm, pas plotësimit të numrit të nevojshëm të dosjeve të aplikantëve për t'ju nënshtruar seancave të këshillimit.</p>		
2.	<b>Pjesëmarrja në proceset gjyqësore në përfaqësim të KSHB</b>	Realizuar	<p>Është marrë pjesë në 30 seanca për realizimin e birësimeve ndërvendase dhe 33 seanca gjyqësore për birësime vendase. Është marrë pjesë gjithashtu në 1 seancë për deklarim braktisje të një fëmije në Elbasan si dhe në një seancë për dhënie informacioni, të thirrur si palë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.</p>	Juristi, Stafi	Janar-Dhjetor 2020
3.	<b>Puna e juristit në raport me</b>	Realizuar	Juristi i KSHB gjatë periudhës së vitit 2020 ka suportuar ligjërisht me këshillim	Stafi, Juristi, Kryetari	Janar-Dhjetor 2020

	<b>agjencitë ndërmjetësuese</b>		ligjor agjensitë përkatëse në fushën e birësimeve që operojnë në Shqipëri, si dhe ka bërë verifikimin e gjithë dokumentacionit përkatës.		
4.	<b>Rinovimi i licensave të agjencive ndërmjetësuese</b>	Në proces	Po punohet për rinovimin e licensave të agjencive ndërmjetësuese në fushën e birësimit si S'Egidio, SPAI, AiBi, AdoptionWorx, Bethany Christian Service. Është ngritur komisioni në Ministrinë e Drejtësisë dhe pas ngritjes së këtij komisioni janë dorëzuar dhe pranuar dosjet me dokumentacionet përkatëse të këtyre agjensive. Gjithashtu gjatë këtij viti është realizuar një mbledhje e komisionit të licensimit dhe në vijim pritet mbledhja e rradhës së këtij komisioni nga Mininstia e Drejtësisë.	Juristi / Kryetari	Janar-Dhjetor 2020

## **II. FUSHA PSIKO - SOCIALE**

Fusha psiko-sociale përbën hallkën kryesore të përgatitjes së aplikantëve si dhe studimin, investigimin e tyre social-psikologjik. Studimi i aplikantëve është i mbështetur tërësisht në etapat kryesore të birësimit si proces që synon gjithmonë të shkojë drejt finalizimit, birësimin e një fëmije. Formimi në mënyrë që aplikantët, familjet e ardhshme birësuese të matura një gadishmëri dhe aftësi reale për t'i bërë ballë problematikave të birësimit. Bashkëpunimi me instancat në nivel rajonal për rritjen e cilësisë së përzgjedhjes së familjes për birësim. Rritja e profesionalizmit, cilësisë së shërbimit, komunikimit dhe etikës nëpërmjet trajnimeve.

NR.	AKTIVITETI / OBJEKTIVI	NIVELI I REALIZIMIT	RRUGËT E REALIZIMIT	PERSONI PËRGJEGJËS	KOHA E REALIZIMIT
1.	<b>Realizimi i seancave të këshillimit</b>	Realizuar 13 seanca këshillimi me 16 çifte aplikantë dhe 3 aplikante të vetme.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përgatitja e aplikantëve për birësim, e cila do të sjellë një integrim sa më të mirë të fëmijës në familjen birësuese;</li> <li>- reflektim mbi etikën e birësimit dhe të drejtat e fëmijës pa kujdes prindëror;</li> <li>-nevojat e një fëmije të braktisur</li> <li>-shqetësime që ekzistojnë mbi fëmijën imagjinar dhe fëmijën real;</li> <li>-krijimi i një marrëdhënie të ngrohtë familjare;</li> <li>-elementë të rëndësishëm për përmbushjen e nevojave psikologjike të fëmijës;</li> <li>-paraqitja e disa rasteve konkrete për vënien përpara një realiteti i cili lejon edhe në matjen e aftësive të tyre për të pranuar një realitet të ndryshëm nga ai ç’ka kishin imagjinuar.</li> </ul>	Specialist Punonjës social, Psikolog	Janar - Dhjetor 2020
2.	<b>Studimi i aplikantëve mbi bazën e intervistave të</b>	Realizuar në total 12 intervista të çifteve që dëshirojnë të birësojnë fëmijë nga institucionet. Janë përfunduar dhe shqyrtuar nga	-Janë bërë intervista të individualizuara në funksion të personalitetit, situatës dhe gjëndjes emocionale të	Specialist Punonjës social, Psikolog	Janar - Dhjetor 2020

	<b>zhvilluara</b>	<p>bordi 12 studime dhe janë 4 të tilla në proces studimi. Realizuar 7 intervista me familje për birësim me pëlqim.</p>	<p>aplikantëve. Më pas është proceduar me studimin e të dhënave të mbledhura prej tyre për të përcaktuar stabilitetin psikologjik ose jo të aplikantëve. Nga studimi që u është bërë familjeve ka rezultuar se një numër jo i vogël familjesh kanë pasur si motivim të tyre fillimisht plotësimin e nevojave të një fëmije të braktisur dhe më pas plotësimin e familjes së tyre. Është e rëndësishme të theksohet fakti, se pas seancave të këshillimit të cilat janë zhvilluar me këto aplikantë, të vihet re një lloj reflektimi që këta të fundit të jenë të hapur përsa i përket gjinisë dhe moshës së fëmijës. Madje në disa raste ata binden që të pranojnë një fëmijë me probleme të vogla fizike dhe psikologjike që mund të ketë pasur fëmija i cili u është prezantuar.</p>		
<b>3.</b>	<b>Marrja e mendimit të fëmijës</b>	<p>Në zbatim të ligjit është marrë pëlqimi i 4 fëmijëve mbi 10 vjeç.</p>	<p>Këto raste u referohen birësimeve me pëlqim ose me lidhje gjaku. Këta fëmijë kanë qënë në gjendje të mirë psikologjike dhe kanë firmosur me dëshirën e tyre</p>	<p>Specialist Psikolog</p>	<p>Janar - Dhjetor 2020</p>

			deklaratën e pëlqimit për birësim.		
4.	<b>Vizita në familje</b>	Realizuar nëpërmjet video call	Gjatë vitit 2020 vizitat në familje nuk janë realizuar fizikisht në familjet e aplikantëve por nëpërmjet video call, ku aplikantët kanë paraqitur pamjet e ambjenteve ku banojnë. Këto pamje janë studiuar nga specialistët dhe më pas janë bashkëlidhur në dosjen e tyre përkatëse, nëpërmjet fotografive të printuara.	-	Janar - Dhjetor 2020
5.	<b>Mbajtja e kontakteve sistematike dhe monitorimi i institucioneve publike dhe jo publike të përkujdesit të fëmijëve</b>	Realizuar	Bazuar në rregulloren për masat e marra ndaj pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, gjatë këtij viti monitorimi i institucioneve të përkujdesit të fëmijëve (publike dhe jopublike) është realizuar nëpërmjet një kalendari të miratuar nga Kryetari dhe institucionet përgjegjëse. Në këtë situatë monitorimet nuk kanë qënë të drejtëpërdrejtë, por on line nëpërmjet platformës Zoom. Janë mbajtur kontakte sistematike me institucione të cilat kanë pasur fëmijë në proces braktisjeje.	Stafi	Janar - Dhjetor 2020

			<p>Problematikat kryesore të cilat janë shfaqur gjatë bisedave me drejtuesit e institucioneve, kanë qënë kryesisht sa i përket deklarimit të braktisjeve së fëmijëve si dhe vonesat apo zvarritjet e tyre në proceset gjyqësore në gjykatat e rretheve kompetente. Raste specifike janë shfaqur në Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shkodër dhe Elbasan.</p> <p>Qëllimi i këtyre monitorimeve ka qënë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-respektimi i afateve ligjore për deklarimin e braktisjes të fëmijës dhe dërgimi i dosjeve të tyre në Komitet brenda afateve;</li> <li>-evidentimi i rasteve të fëmijëve të cilët kanë shanse të pakta për t'u rikthyer në familjen e tyre biologjike;</li> <li>-në fund të tyre janë zbardhur procesverbalet përkatëse.</li> </ul>		
6.	<b>Ndjekja e procedurave të birësimit ndërvendas dhe bashkëpunimi me Agjencitë ndërmjetësuese dhe Autoritetet Qëndrore</b>	Realizuar	Gjatë këtij viti KSHB ka realizuar 8 birësime ndërvendase nga të cilat 2 me problematika të rënda shëndetësore, 4 nga komuniteti rom, 1 nga komuniteti egjiptian, 1	Stafi	Janar – Dhjetor 2020



			shëndetshëm		
7.	<b>Kryerja e relacionit të përshtatjes prind-fëmijë gjatë periudhës së përshtatshmërisë</b>	Realizuar	Specialisti psikolog mban kontakte me institucionet e përkujdesit të të miturve për të vlerësuar mbarvajtjen e periudhës së përshtatjes prind-fëmijë. Nga kontaktet e mbajtura hartohet edhe një relacion i cili është pjesë e dosjes të birësimit që do të shqyrtohet nga gjykata e rrethit kompetent. Për vitin 2020 janë realizuar 17 relacione të tilla përshtatshmërie (për 5 birësime nuk kanë filluar ende proceset gjyqësore).	Specialist Psikolog	Janar – Dhjetor 2020
8.	<b>a. Ndjekja e ecurisë pasbirësuese të fëmijëve të birësuar nga aplikantë shqiptar</b>	Realizuar 32 raporte pasbirësuese	Në bazë të një marrëveshjeje të brendshme, e cila nënshkruhet ndërmjet aplikantit birësues dhe KSHB, realizohen për një periudhë kohore 2 vjeçare 4 raporte pasbirësuese.	Specialist, Punonjës Social,	Janar – Dhjetor 2020

	<b>b. Ecuria pasbirësuese e fëmijëve të birësuar nga aplinkantë të huaj</b>	Janë përcjellë nëpër institucionet e fëmijëve 34 raporte të përgatitura nga specialistë të agjensive ndërkombëtare mbi ecurinë pasbirësuese për fëmijët e birësuar jashtë vendit, nga të cilat 1 raport ka ardhur nga A.Q.Grek, 16 nga AdoptionWorx Kanada, 4 nga Night Light Cristian Adoption, 1 nga S'Egidio, 2 nga SPAI, 3 nga AFA Francë, 6 nga AiBi, 1 nga APOGG Maltë.	Agjencitë ndërmjetësuese dhe autoritet Qëndrore dërgojnë në KSHB për një periudhë 2 vjeçare 4 raporte pasbirësuese për të miturit e birësuar jashtë territorit shqiptar.	Psikolog, Stafi	
--	---	---	--	--------------------	--

<b>9.</b>	<b>Realizimi i procedurave të prokurimeve sipas rregjistrimit të parashikimeve për vitin 2020</b>	U realizuan brenda afateve ligjore 22 procedura prokurimi nga të cilat 2 prej tyre ishin prokurim “Blerje me vlerë të vogël”.	Plotësimi i rregjistrimit me të dhënat për prokurimet e realizuara gjatë vitit 2020.  Planifikimi sa më i drejtë i nevojave të KSHB për mallra/shërbime/punë gjatë vitit 2020, plotësimi i rregjistrimit me këto të dhëna.	Specialist Psikolog,  Komisioni i Prokurimit me vlera të vogla dhe blerjeve me vlerë nën 100.000 lekë	Janar – Dhjetor 2020
-----------	---	---	--	--	-------------------------

### III. KËSHILLI DREJTUES

NR.	AKTIVITETI / OBJEKTIVI	NIVELI I REALIZIMIT	RRUGËT E REALIZIMIT	PERSONI PËRGJEGJËS	KOHA E REALIZIMIT
1.	Realizimi i mbledhjeve të Këshillit Drejtues	Realizuar 10 mbledhje	Janë shqyrtuar nga bordi : - 8 raste birësimi ndërvendase nga të cilat 2 me problematika të rënda shëndetësore, 4 nga komuniteti rom, 1 nga komuniteti egjiptian, 1 shëndetshëm. - 11 birësime vendase nga të cilat 10 fëmijë të shëndetshëm dhe 1 me vonesë dhe prapambetje mendore - 7 birësime me pëlqim <b>26 birësime në total</b>	Specialist Shkenca Sociale	Janar – Dhjetor 2020

### IV. FUSHA FINANCIARE

Gjatë vitit 2020, zyra e financës është angazhuar për kryerjen e detyrave dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në planin e punës për vitin 2020.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2020, është punuar intesivisht për planifikimin e nevojave buxhetore dhe ndjekjen e zbatimit të buxhetit me qëllim financimin e të gjitha aktiviteteve të instituconit, si dhe përballimin e kushteve të veçanta të krijuara nga pandemia COVID-

19. Si rezultat i monitorimit të buxhetit dhe rialokimit të tij gjatë vitit, është arritur likujdimi i të gjitha shpenzimeve në kohë pa krijuar në asnjë rast detyrime të prapambetura, si dhe janë shfrytëzuar fondet buxhetore me efektivitet maksimal.

Të gjitha aktivitetet e realizuara kanë qënë në përputhje me përshkrimin e miratuar të punës dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, konkretisht:

- Ligji nr.9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”, i ndryshuar;
- Rregullorja e Brendshme e Komitetit Shqiptar të Birësimeve miratuar nga Ministria e Drejtësisë;
- Ligji nr.88/2020 “Për buxhetin e vitit 2020”, si dhe të gjithë udhëzimet plotësuese të tij;
- Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Udhëzimit nr.383/8, datë 29.04.2013 “Për përcaktimin e tarifave për shërbimet e Komitetit Shqiptar të Birësimeve”;
- Legjislacionin në fuqi në fushën e prokurimeve publike.

Analiza e arritjes dhe realizimit të detyrave paraqitet si më poshtë:

NR.					
<b>1</b>	<b>Qëllimi:</b> Sigurimi dhe mbrojtja e fëmijëve të mitur të shpallur të braktisur me vendim gjykate, duke garantuar gjithmonë interesin më të lartë për këta fëmijë, nëpërmjet krijimit të familjeve të reja të përshtatshme për ta, monitorimit të ecurisë pasbirësuese dhe ofrimit të një shërbimi cilësor në përputhje me legjislacionin në fuqi. Planifikimi dhe përdorimi i fondeve buxhetore me efektivitet, efikasitet dhe produktivitet.				
<b>1.1</b>	<b>Objektivi 1.1:</b> Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i fondeve buxhetore të miratuara nga Buxheti i Shtetit. Mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare shoqëruese të tij.				
	<b>AKTIVITETI</b>	<b>RRUGËT E REALIZIMIT</b>	<b>PERSONI PËRGJEGJËS</b>	<b>AFATI</b>	<b>NIVELI I REALIZIMIT</b>
<b>1.1.1</b>	-Mbyllja e llogarive kontabël të hapura gjatë vitit 2019.	Kuadrimi i llogarive të vitit 2019 dhe hedhja e tyre në evidencat	Specialisti Financës	Janar 2020	<b>Realizuar</b> - U bë mbyllja e llogarive kontabël.

		kontabël.			- U plotësuan regjistrat dhe ditarët kontabël. - Nga rakordimi mes tyre nuk rezultoi asnjë diferencë.
<b>1.1.2</b>	-Çelja e fondeve për të gjitha llogaritë ekonomike për vitin 2020. -Çelja e fondeve për prokurimet publike për vitin 2020.	Detajimi i buxhetit të vitit 2020 sipas llogarive ekonomike për shpenzimet korrente dhe kapitale.	Specialisti Financës	Janar 2020	<b>Realizuar</b> - U përgatit plani i arkës, u bë detajimi i buxhetit të vitit 2020 sipas artikujve kontabël për çdo muaj të vitit dhe u dorëzua në MD.
<b>1.1.3</b>	-Përgatitja dhe dorëzimi i Raporteve të monitorimit për vitin 2019.	-Plotësimi i pasqyrave të Raporteve të monitorimit me të dhënat e kërkuara për vitin 2019. - Dorëzimi në afat pranë MD.	Specialisti Financës	Shkurt 2020	<b>Realizuar</b> -U plotësuan pasqyrat e Raporteve të monitorimit me të dhënat mbi shpenzimet dhe investimet e realizuara si dhe mbi realizimin e produktit të institucionit për vitin 2019. - U dorëzuan në afat pranë MD nëpërmjet shkresës nr.94 prot, dt. 10.02.2020.
<b>1.1.4</b>	-Përfundimi i Bilancit Vjetor Kontabël për vitin 2019.	- Kuadrimi i llogarive kontabël për vitin 2019 dhe përpilimi i pasqyrave financiare. - Dorëzimi në afat pranë MD.	Specialisti Financës	Mars 2020	<b>Realizuar</b> -U hartua Bilanci Vjetor Kontabël dhe pasqyrat shoqëruese të tij për vitin 2019. - U miratua nga Specialisti i Degës së Thesarit. - U dorëzua brenda afatit në MD nëpërmjet shkresës nr.31/2 prot, dt. 03.03.2020, si dhe në Degën e Thesarit Tiranë nëpërmjet shkresës nr.31/1 prot, dt. 03.03.2020.
<b>1.1.5</b>	-Likujdimi i të gjitha detyrimeve	- Përgatitja e urdhër shpenzimeve	Specialisti	Janar-	<b>Realizuar</b>

	dhe shlyerja e pagesave.	sipas dokumentacionit justifikues të pagesave. - Dorëzimi në afat pranë Degës së Thesarit.	Financës	Dhjetor 2020	- Gjatë vitit janë llogaritur detyrimet e krijuara, si dhe janë përgatitur dhe dorëzuar në Degën e Thesarit urdhër shpenzimet përkatëse për të vijuar me likuidimin e tyre.  <b>Theksojmë se, gjatë gjithë vitit 2020, institucioni ynë nuk ka patur asnjë detyrim të prapambetur të krijuar rishtazi apo të mbartur nga periudha të mëparshme.</b>
<b>1.1.6</b>	-Llogaritja, deklarimi online, likuidimi dhe kontabilizimi i pagave të punonjësve, sigurimeve dhe tatimeve të lidhura me to, si dhe i tatimit në burim.	Llogaritja e pagave, sigurimeve dhe tatimeve, deklarimi online i tyre dhe likuidimi brenda afatit.	Specialisti Financës	Janar-Dhjetor 2020	<b>Realizuar</b> -Janë llogaritur pagat e punonjësve dhe sigurimet e tatimet mbi to online në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore HRMIS. - Janë deklaruar online në sistemin e tatimeve sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi në burim. - Janë kryer pagesat brenda afatit dhe është bërë regjistrimi i tyre në Librin e pagave.
<b>1.1.7</b>	-Kontabilizimi i të gjitha shpenzimeve; -Rakordimi me Degën e Thesarit për realizimin e shpenzimeve; -Përgatitja e Situacionit të shpenzimeve mujore dhe	Mbajtja rregullisht e ditarëve dhe librave kontabël, rakordimi me Degën e Thesarit, dhe raportimi i realizimit të shpenzimeve korrente dhe kapitale pranë Ministrisë së Drejtësisë.	Specialisti Financës	Janar-Dhjetor 2020	<b>Realizuar</b> - Janë hedhur dhe pasqyruar të gjitha shpenzimet e kryera gjatë vitit në librat kontabël. -Janë krahasuar vlerat e shpenzimeve mujore dhe progresive sipas institucionit

	<p>progresive; -Përgatitja e Evidencës së shpenzimeve progresive dhe relacioni shoqërues.</p>			<p>me vlerat e tyre sipas Degës së Thesarit, ku në asnjë rast nuk ka patur diferenca; -Është plotësuar Situacioni mujor i shpenzimeve me të dhënat e nevojshme, është firmosur nga specialistja e thesarit dhe është dorëzuar një kopje në Degën e Thesarit-Sektorin e shpenzimeve; -Është plotësuar evidenca mujore e shpenzimeve me të dhëna për përdorimin e fondeve sipas artikujve përkatës për periudhat raportuese, është përgatitur relacioni shoqërues dhe është dorëzuar në rrugë elektronike çdo muaj pranë MD.</p> <p><i>Situacioni Shpenzimeve Janar-Dhjetor 2020 paraqitet si në vijim:</i></p> <p>Llogaria ekonomike <b>600 (Paga)</b> – Plan 5.110.000 leke / Fakt 5.109.355 lekë (Realizimi 99,99%);</p> <p>Llogaria ekonomike <b>601 (Sigurime shoqërore)</b> – Plan 850.000 / Fakt 846.673 lekë (Realizimi 99,6%);</p> <p>Llogaria ekonomike <b>602 (Mallra dhe shërbime)</b> – Plan 3.010.000 lekë / Fakt 2.899.339 lekë (Realizimi 96,3%).</p>
--	---	--	--	---

					<p>Për shpenzimet korente (paga, sigurime shoqërore, mallra dhe shërbime) paraqitet një realizim mjaft i lartë i fondeve, pothuajse në masë të plotë, i cili varion 96,3% - 100%.</p> <p>Llogaria ekonomike <b>606 (Transferta te buxhete familjare dhe individë)</b> – Plan 100.000 lekë / Fakt 0 lekë.</p> <p>Ky fond prej 100.000 lekë nuk është pjesë e parashikimeve buxhetore për vitin 2020, por i është miratuar KSHB nga fondi i veçantë. Duke qënë se, gjatë vitit nuk janë paraqitur situatat e përcaktuara në aktet ligjore përkatëse për përfitimin nga kjo llogari, fondi nuk është shpenzuar.</p> <p>Llogaria ekonomike <b>231 (Investime kapitale të trupëzuara)</b> – Plan 2.000.000 / Fakt 1.256.250 lekë (Realizimi 62,8%).</p> <p>Sa i takon shpenzimeve kapitale, ka diferenca në realizim pasi fondi prej 2.000.000 lekë, në fillim të vitit u parashikua për rikonstrukcion të</p>
--	--	--	--	--	---



					<p>pjesshëm të godinës ku KSHB ushtron veprimtarinë. Duke qënë se, gjatë vitit nuk u realizuar kalimi i godinës në përgjegjësi administrimi të KSHB, proces i cili nuk është në fushën e përgjegjësisë së institucionit tonë, u ndryshua projekti i investimit në “Blerje pajisje zyre” dhe “Blerje pajisje elektronike”. Pasi u evidentuan të gjitha nevojat e institucionit për pajisje zyre dhe elektronike, u kryen procedurat e prokurimit dhe likujdimet përkatëse.</p> <p>Diferenca prej 743.750 lekë është raportuar si fond i lirë pranë Ministrisë së Drejtësisë në rrugë zyrtare dhe elektronike.</p> <p><b>Në total për vitin 2020, Buxheti paraqitet: Plan 11.070.000 lekë / Fakt 10.111.617 lekë (Realizimi 91,3%).</b></p> <p>Duke analizuar diferencën në realizim prej 8,7% sipas llogarive ekonomike, rezulton se kjo diferencë lidhet drejtpërdrejtë me fondet e lira në artikullin 606 (nga fondi i veçantë) dhe 231 (fonde të raportuara si fond i lirë).</p> <p><b>Në këto kushte, mund të themi se planifikimi i buxhetit, si dhe ndjekja</b></p>
--	--	--	--	--	--

					<b>dhe monitorimi i tij gjatë vitit janë realizuar drejt.</b>
<b>1.1.8</b>	-Përgatitja dhe dorëzimi i Raporteve të monitorimit për 4-mujorin dhe 8-mujorin e vitit 2020.	- Përgatitja e të dhënave mbi situatën Plan/Fakt të shpenzimeve korrente dhe kapitale, si dhe informacioni mbi realizimin e produkteve të institucionit; - Dorëzimi në afat pranë MD.	Specialisti Financës	Maj 2020 Shtator 2020	<b>Realizuar</b> -Janë plotësuar pasqyrat e Raporteve të monitorimit me të dhënat mbi shpenzimet dhe investimet e realizuara si dhe mbi realizimin e produkteve të institucionit për periudhën Janar-Prill 2020 dhe Janar-Gusht 2020. - U dorëzuan në afat pranë MD nëpërmjet shkresave nr.272 prot, dt. 15.05.2020 dhe nr.571 prot, dt. 15.09.2020, si dhe elektronikisht.
<b>1.1.9</b>	-Përgatitja dhe raportimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 (PBA 2021-2023). -Planifikimi i buxhetit të viti 2021.	- Hartimi sa më i drejtë i politikës së programit të KSHB. -Planifikimi i produkteve dhe nevojave për fonde për të gjithë artikujt kontabël (600, 601, 602) për shpenzimet korrente, si dhe planifikimi i fondeve për investime (artikulli 231). -Dorëzimi brenda afatit në MD.	Specialisti Financës	Gusht 2020	<b>Realizuar</b> -Pasi u përcaktua politika e programit, objektivat dhe treguesit e performancës, u parashikuan nevojat për fonde për çdo produkt dhe sipas artikujve kontabël përkatës për shpenzimet korrente dhe kapitale për vitin 2021. - U hodh dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 në sistemin online AFMIS dhe u miratua nga titullarët. - U dorëzuan në afat pranë MD nëpërmjet shkresës nr.520 prot, dt. 11.08.2020, si dhe elektronikisht.
<b>1.1.10</b>	-Ndjekja dhe monitorimi i vazhdueshëm i buxhetit të vitit	-Monitorimi i zbatimit të fondeve buxhetore duke krahasuar vlerat	EMP;	Janar-Dhjetor	<b>Realizuar</b>

	<p>2020;</p> <p>-Kryerja e rialokimeve të nevojshme të fondeve buxhetore me qëllim mos krijimin e detyrimeve të prapambetura të lindura rishtazi.</p>	<p>plan/fakt si dhe duke parashikuar vlerën e shpenzimeve potenciale;</p> <p>-Rialokim i fondeve buxhetore brenda ose jashtë programit të institucionit tonë duke bashkërenduar punën edhe me Ministrinë e Drejtësisë,</p> <p>- Miratimi i Aktive Normative përkatëse për vitin 2020.</p>	<p>Specialisti Financës</p>	<p>2020</p>	<p>- Gjatë vitit 2020, është ndjekur dhe monitoruar çdo muaj realizimi i buxhetit, janë parashikuar fondet e tepërta për çdo llogari ekonomike, si dhe është bashkërenduar puna me MD për rialokimin e këtyre fondeve jashtë programit të institucionit. Gjithashtu, në rialokimin e fondeve gjatë vitit ka ndikuar edhe situata e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.</p> <p>Për vitin 2020, nuk ka patur asnjë shtesë fondi nga fondi i miratuar në fillim të vitit. Nga ana tjetër, janë pakësuar fonde nëpërmjet 3 akteve normative, konkretisht:</p> <p><b>1. Akti Normativ nr.15, datë 15.04.2020:</b> janë pakësuar 150.000 lekë nga llog. ekonomike 602 (mallra dhe shërbime).</p> <p><b>2. Akti Normativ nr.28, datë 02.07.2020:</b> janë pakësuar 1.000.000 lekë nga llog. ekonomike 602 (mallra dhe shërbime).</p> <p><b>3. Akti Normativ nr.34, dt. 16.12.2020:</b> janë pakësuar 3.390.000 lekë nga llog. ekonomike 600 (paga); 650.000 lekë nga llog. ekonomike 601 (sigurime</p>
--	---	---	---------------------------------	-------------	--

					<p>shoqërore) dhe 340.000 lekë nga llog. ekonomike 602 (mallra dhe shërbime).</p> <p><i>Arsyet e rialokimit të fondeve buxhetore paraqiten, si më poshtë:</i></p> <p><b>Llog.ekonomike 600</b> (Paga) – Pakësuar në total gjatë vitit 3.390.000 lekë</p> <p><b>Llog.ekonomike 601</b> (Sigurime shoqërore) – Pakësuar në total gjatë vitit 650.000 lekë</p> <p>Arsyeja e krijimit të diferencave për këto llogari është se struktura organike e institucionit ka qënë e paplotësuar gjatë gjithë vitit 2020, konkretisht pozicionet që kanë qënë vakante janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pozicioni Kryetar – Kategori page II-B, Periudha e Vakancës Janar 2020;</li> <li>2. Pozicioni Specialist (Psikolog) – Kategori page IV-A, Periudha e Vakancës Mars-Dhjetor 2020;</li> <li>3. Pozicioni Specialist (Shkenca sociale) – Kategori page IV-A, Periudha e Vakancës Janar-Dhjetor 2020;</li> <li>4. Pozicioni Specialist (Shkenca sociale) – Kategori page IV-B, Periudha e Vakancës Shtator-Dhjetor 2020</li> </ol>
--	--	--	--	--	---

					<p>(Punonjësja është larguar me leje barrëlindje).</p> <p>Duke qënë se, planifikimi i fondeve buxhetore është bërë mbështetur në strukturën e miratuar të institucionit, vakancat gjatë vitit 2020 kanë sjell uljen e shpenzimeve faktike për paga dhe sigurime shoqërore. Diferenca e fondeve është përlogaritur dhe është deklaruar si fond i lirë me qëllim përdorimin e fondeve me sa më shumë efektivitet.</p> <p><b>Llog.ekonomike 602</b> (Mallra dhe shërbime) – Pakësuar në total gjatë vitit 1.490.000 lekë</p> <p>Arsyeja e krijimit të diferencave është se nuk janë realizuar të gjitha procedurat e prokurimit publik të parashikuara në fillim të vitit në regjistrin e prokurimeve publike, kushtëzuar kjo edhe nga situata e krijuar prej pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, konkretisht: fondi i parashikuar me tvsh 2.153.999 lekë / fondi i realizuar me tvsh 1.594.268 lekë (realizimi 74%).</p> <p>Një tjetër arsye është edhe ulja e shpenzimeve për honorare, konkretisht:</p>
--	--	--	--	--	--

					Plan 1.200.000 lekë / Fakt 892.000 lekë (Realizimi 74,3%).
<b>1.1.11</b>	-Mbyllja e veprimeve financiare për vitin 2020.	-Llogaritja dhe likujdimi i të gjitha detyrimeve të lindura, në mënyrë që të mos krijohen apo mbarten detyrime të prapambetura për vitin në vazhdim.	Specialisti Financës	Dhjetor 2020	<b>Realizuar</b> - Gjatë muajit Dhjetor 2020, është bërë kontabilizimi dhe likujdimi i detyrimeve të krijuara ndaj punonjësve të institucionit dhe palëve të treta. - Të gjitha detyrimet e lindura janë likujtuar brenda afateve ligjore duke mos krijuar asnjë detyrim të prapambetur.
<b>1.2</b>	<b>Objektivi 1.2:</b> Menaxhimi i procesit të arkëtimit të të ardhurave dytësore të institucionit				
	<b>AKTIVITETI</b>	<b>RRUGËT E REALIZIMIT</b>	<b>PERSONI PËRGJEGJËS</b>	<b>AFATI</b>	<b>NIVELI I REALIZIMIT</b>
<b>1.2.1</b>	-Menaxhimi i procesit të arkëtimit të të ardhurave dytësore të institucionit, përlllogaritja, faturimi dhe kontabilizimi i të ardhurave dytësore nga tarifat e birësimit sipas llojit të tyre.	-Përgatitja e Faturave për arkëtim me tarifat përkatëse sipas specifikave ligjore; hedhja dhe pasqyrimi i të ardhurave të realizuara në librat kontabël.	Specialisti Financës	Janar- Dhjetor 2020	<b>Realizuar</b> Janë përgatitur dhe dorëzuar faturat për arkëtim me tarifat përkatëse sipas llojeve të birësimit; janë kontabilizuar të ardhurat dytësore në ditarin kontabël të të ardhurave.
<b>1.2.2</b>	-Rakordimi me Degën e Thesarit për realizimin e arkëtimeve për çdo muaj gjatë vitit; -Përgatitja e Akt-Rakordimit mujor për të ardhurat mujore dhe progresive.	- Krahasimi i vlerave të të ardhurave mujore dhe progresive sipas institucionit me vlerën e tyre sipas Degës së Thesarit; - Plotësimi i Akt-Rakordimit me të dhënat e nevojshme, firmosja nga specialistja e thesarit dhe dorëzimi i	Specialisti Financës	Janar- Dhjetor 2020	<b>Realizuar</b> - Janë rakorduar çdo muaj të ardhurat mujore dhe progresive me sistemin SIFQ, nga i cili nuk rezultojnë diferenca mes të dhënave sipas Degës së Thesarit me vlerat sipas KSHB. - Janë përgatitur Akt-Rakordimet mujore

		një kopje në Degën e Thesarit-Sektorin e të ardhurave.			të të ardhurave dhe një kopje e tyre është dorëzuar në Degën e Thesarit. - Sipas Akt-Rakordimit përmbledhës për periudhën Janar-Dhjetor 2020, të ardhurat e arkëtuara në emër të institucionit tonë rezultojnë në masën 964.820 lekë, të cilat janë derdhur 100% në Buxhetin e Shtetit.
<b>1.3</b>	<b>Objektivi 1.3:</b> Realizimi i detyrave të ngarkuara dhe bashkërendimi i punës me stafin e institucionit për mbarëvajtjen e punës.				
	<b>AKTIVITETI</b>	<b>RRUGËT E REALIZIMIT</b>	<b>PERSONI PËRGJEGJËS</b>	<b>AFATI</b>	<b>NIVELI I REALIZIMIT</b>
<b>1.3.1</b>	-Bashkërendimi i punës me Komisionin e prokurimeve me vlera të vogla dhe blerjeve me vlerë nën 100.000 lekë; -Likujdimi i të gjitha faturave për prokurimet/blerjet e realizuara.	-Evidentimi i nevojave për mallra/shërbime/punë që do të prokurohen në përputhje me fondet e disponueshme dhe hartimi i Regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2020;  -Kryerja e pagesës së faturave për mallrat e blera/shërbimet e kryera pasi operatorët ekonomik fitues kanë përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara nga ana e institucionit.	Specialisti Financës, Komisioni i prokurimeve me vlera të vogla dhe blerjeve me vlerë nën 100.000 lekë	Janar-Dhjetor 2020	<b>Realizuar</b> - Është bashkërenduar puna me komisionin e prokurimeve me vlera të vogla dhe blerje me vlerë nën 100.000 lekë për hartimin e regjistrit të parashikimit për vitin 2020, si dhe gjatë zhvillimit të procedurave të blerjeve; - Gjatë vitit, janë kryer të gjitha pagesat për procedurat e prokurimit apo blerjeve me vlerë nën 100.000 lekë brenda afateve, në përputhje me Regjistrin e parashikimeve për vitin 2020, si dhe pasi praktika për çdo procedurë është dorëzuar e përfunduar pranë zyrës së financës.  Gjatë vitit 2020, nga shpenzimet

					korrente janë realizuar 18 procedura blerje me vlerë nën 100.000 lekë me vlerë totale 1.594.268 lekë me tvsh, kurse nga fondet e investimeve janë realizuar 2 procedura blerje me vlere nën 100.000 lekë dhe 2 procedura prokurim me vlerë të vogël me vlerë totale 1.256.250 lekë me tvsh.
1.3.2	-Bashkërendimi i punës për mbajtjen e veprimeve të magazinës dhe kontabilizimi i hyrjeve dhe daljeve të mallrave dhe aktiveve afatgjata të institucionit.	-Hedhja dhe pasqyrimi i vlerave kontabël hyrëse, dalëse dhe gjendje të magazinës në ditarin e magazinës. Rakordimi i ditarit të magazinës me fletë hyrjet, fletë daljet dhe faturat përkatëse.	Specialisti Financës Specialisti i ngarkuar me mbajtjen e magazinës	Janar-Dhjetor 2020	<b>Realizuar</b> Është bashkërenduar puna me punonjës të magazinës; është mbajtur ditari i magazinës sipas të dhënave të dorëzuara pranë zyrës së financës; janë rakorduar faturat e blerjes me fletë hyrjet, fletë daljet dhe të dhënat sipas ditarit të magazinës.
1.3.3	-Hartimi i Regjistrit të Riskut për vitin 2020.	Evidentimi i risqeve të mundshme të institucionit gjatë punës për vitin 2020.	Specialisti Financës; Stafi i KSHB	Janar 2020	<b>Realizuar</b> -U përgatit Regjistri i Riskut për vitin 2020, në të cilin janë paraqitur të gjithë risqet që shoqërojnë proceset që KSHB zhvillon, nivelin/shkallën e këtyre risqeve si dhe mënyrat e kontrollit që nevojiten për reduktimin e tyre.
1.3.4	-Përgatitja e pyetësorit të vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2019.	- Raportimi i informacionit të kërkuar sipas formatit të pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2019. - Dorëzimi në afat pranë MD.	Specialisti Financës	Shkurt 2020	<b>Realizuar</b> -U plotësua pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2019. - U plotësua Deklarata për cilësinë e



					<p>sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2019.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- U plotësua Plani i zhvillimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.</li> <li>- U dorëzuan zyrtarisht në afat pranë MD, si dhe në rrugë elektronike.</li> </ul>
1.3.5	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Hartimi i statistikave përmbledhëse të institucionit për tregues dhe periudha të ndryshme sipas nevojave të punës;</li> <li>- Përgatitja e treguesve statistikor të vitit 2019 sipas formatit të kërkuar nga Agjencia Shtetërore e të Drejtave dhe Mbrotjes së Fëmijëve;</li> <li>-Raportimi mujor i indikatorëve të institucionit për sistemin e-Raport.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, si dhe përgatitja e statistikave përmbledhëse për tregues të ndryshëm për vitin 2019, si dhe gjatë vitit 2019 sipas nevojave të punës.</li> <li>-Përgatitja e të dhënave për 5 (pesë) indikatorët e institucionit tonë çdo muaj gjatë vitit dhe dërgimi i tyre në rrugë elektronike pranë MD.</li> </ul>	<p>Specialisti Financës</p> <p>Specialisti i ngarkuar me mbajtjen e regjistrave të fëmijëve dhe çifteve</p>	<p>Janar-Dhjetor 2020</p>	<p><b>Realizuar</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Janë mbledhur të dhënat e nevojshme dhe janë përgatitur statistikat përmbledhëse për vitin 2019;</li> <li>- Janë hartuar statistikat për tregues të ndryshëm dhe periudha kohore të ndryshme, të cilat janë nevojitur gjatë punës.</li> <li>- Janë hartuar dhe dërguar statistikat lidhur me birësimet e realizuara gjatë vitit 2019, sipas formatit të kërkuar nga Agjencia Shtetërore e të Drejtave dhe Mbrotjes së Fëmijëve;</li> <li>- Janë përgatitur të dhënat për 5 (pesë) indikatorët e institucionit tonë për çdo muaj gjatë vitit dhe janë dorëzuar elektronikisht pranë MD brenda afatit të kërkuar.</li> </ul>
1.3.6	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Mbajtja rregullisht e marrëdhënieve me sigurimet shoqërore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Përgatitja dhe dorëzimi i listëpagesave për raportet mjeksore dhe për raportin për leje barrëldje për punonjësen e institucionit tonë.</li> </ul>	<p>Specialisti Financës</p>	<p>Janar-Dhjetor 2020</p>	<p><b>Realizuar</b></p> <p>Janë përgatitur dhe dorëzuar pranë Sigurimeve shoqërore listëpagesat mujore për punonjësen me raport për</p>

					<p>leje barrëlindje, si dhe janë hedhur elektronikisht në sistemin e-albania raportet mujore dhe listëpagesat përkatëse.</p> <p>Gjatë vitit 2020, nuk ka patur asnjë raport mjeksor mbi 14 ditë, i cili paguhet nga sigurimet shoqërore.</p>
1.3.7	- Mbajtja rregullisht e marrëdhënieve me bankat e nivelit të dytë.	- Përgatitja dhe dorëzimi në afat i listëpagesave në banka pasi të jenë kaluar fondet nga thesari.	Specialisti Financës	Janar-Dhjetor 2020	<p><b>Realizuar</b></p> <p>Gjatë vitit, janë përgatitur listëpagesat për pagat e punonjësve, honoraret e Këshillit Drejtues, dietat e punonjësve për shërbime në rrethe, dhe pasi kanë kaluar fondet nga thesari, listëpagesat janë dorëzuar pranë bankave të nivelit të dytë.</p>
1.3.8	-Kryerja e raportimit në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.237, datë 13.12.2017 “Për disiplinimin e kryerjes së pagesave të ujit nga Ministritë, Institucionet e varësisë dhe punonjësit e tyre”.	-Përgatitja e të dhënave lidhur me likuidimin e pagesave për ujin e pijshëm sipas formatit të kërkuar dhe raportimi në rrugë elektronike pranë MD.	Specialisti Financës	Janar-Dhjetor 2020	<p><b>Realizuar</b></p> <p>- Raportimi me të dhënat e kërkuara është përgatitur çdo muaj dhe është dorëzuar elektronikisht pranë MD.</p> <p>- Gjatë vitit, institucioni ka likuiduar të gjitha detyrimet për ujin e pijshëm brenda afateve, duke mos krijuar asnjë detyrim të papaguar. Po ashtu, asnjë punonjës i institucionit nuk ka rezultuar debitor ndaj UKT.</p>
1.3.9	- Mbajtja e marrëdhënieve me ILDKPKI, si dhe ushtrimi i detyrës së Autoritetit Përgjegjës; -Raportimi në afat pranë	-Monitorimi i rasteve të konfliktit të interesit dhe sugjerimi i marrjes së masave për shmangien e tij; -Ndjekja e procesit të deklarimit të	Specialisti Financës	Janar-Dhjetor 2020	<p><b>Realizuar</b></p> <p>- Nga ana e institucionit janë përmbushur të gjitha detyrimet lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave</p>

	<p>ILDKPKI.</p>	<p>pasurisë në afat për personat që kanë detyrim për deklarim për institucionin tonë si dhe dorëzimi dorazi i deklaratës pranë ILDKPKI;</p> <p>-Përgatitja në afat e analizës vjetore të punës në fushën e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave dhe dorëzimi i një kopje të saj pranë ILDKPKI.</p> <p>- Raportimi mbi ndryshimin e subjektit deklarues për KSHB.</p>		<p>personale, si dhe me evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave në zbatim të plotë të legjilacionit në fuqi dhe Rregullores së Brendshme “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Komitetin Shqiptar të Birësimeve”;</p> <p>- Gjatë vitit, janë kryer rregullisht njoftimet te subjektet përkatëse lidhur me detyrimin për kryerjen e deklarimit të pasurisë dhe interesave private;</p> <p>- Është ndjekur procesi i dorëzimit të deklaratave të pasurisë pranë ILDKPKI: në dy raste gjatë vitit dorëzimi i deklaratave është bërë nga Autoriteti Përgjegjës brenda afateve të përcaktuara;</p> <p>- Është përgatitur analiza vjetore e punës në fushën e deklarimit të pasurisë dhe interesave private, si dhe regjistri i rasteve të konfliktit të interesave, dhe janë dorëzuar brenda afatit në rrugë zyrtare dhe elektronike pranë ILDKPKI.</p> <p>- Gjatë vitit, nuk është evidentuar asnjë rast i konfliktit të interesave;</p> <p>- Gjithashtu, është njoftuar në rrugë zyrtare ILDKPKI lidhur me ndryshimin e subjekteve që mbartin detyrim për deklarim për KSHB. Në vitin 2020, ka patur vetëm një ndryshim të subjektit</p>
--	-----------------	---	--	--

					deklarues.
<b>1.3.10</b>	-Përgatitja dhe raportimi në afat i evidencave të kërkuara nga INSTAT pranë MD.	-Përgatitja dhe raportimi elektronikisht i evidencave 2PU, 7PU dhe 9PU për të dhënat e vitit 2019 dhe ato për 3/mujorin, 6/mujorin dhe 9/mujorin e vitit 2020 të punonjësve dhe pagave të tyre për institucionin tonë.	Specialisti Financës	Janar 2020 Prill 2020 Korrik 2020 Tetor 2020	<b>Realizuar</b> - Janë mbeldhur dhe përpunuar të dhënat lidhur me numrin e punonjësve, nivelit të pagave dhe arsimit të tyre, si dhe janë paraqitur në formatet e evidencave të kërkuara nga INSTAT për vitin 2019, si dhe për tre 3-mujorët e parë të vitit 2020; - Evidencat janë dërguar brenda afateve pranë MD në rrugë elektronike. - Gjithashtu janë përgatitur dhe dërguar në rrugë shkresore dhe elektronike të dhënat statistikore për vitet 2017, 2018 dhe 2019, të kërkuara nga INSTAT në kuadër projektit në bashkëpunim me UNICEF “Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri”.
<b>1.3.11</b>	- Realizimi i detyrave në rolin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	- Pritja e kërkesave për informacion dhe ndjekja e kthim përgjigjeve brenda afateve ligjore; - Paraqitja e kërkesave në Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve për vitin 2020.	Specialisti Financës Stafi i KSHB	Janar-Dhjetor 2020	<b>Realizuar</b> - Të gjitha kërkesat për informacion të paraqitura gjatë vitit pranë Koordinatorit, nëpërmjet MD apo në adresat elektronike të Koordinatorit dhe <a href="mailto:info@kshb.gov.al">info@kshb.gov.al</a> , janë trajtuar sipas natyrës së kërkesës dhe kanë marrë përgjigje në kohë brenda afateve ligjore; - Gjatë vitit, është mbajtur regjistri i

					kërkesave dhe përgjigjeve sipas formatit të kërkuar për çdo rast të paraqitur pranë KSHB, si dhe është bërë publikimi i tij në faqen web të institucionit <a href="http://www.kshb.gov.al">www.kshb.gov.al</a> .
<b>1.3.12</b>	-Përmirësimi i praktikave të punës nëpërmjet trajnimeve dhe takimeve në grup.	-Pjesëmarrje në trajnime dhe takime që zhvillohen për fusha dhe detyra që lidhen me pozicionin e punës.	Specialisti Financës	Janar-Dhjetor 2020	<p><b>Realizuar</b></p> <p>Gjatë vitit, është marrë pjesë në aktivitetet, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Shkurt 2020</b> – Takimi mbi Mekanizmin Institucional për Monitorimin e Strategjisë për të Mitur 2018-2021, zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë;</li> <li><b>2. Shkurt 2020</b> – Takim bashkëpunimi mbi hedhjen e Programit Buxhetor Afatmesëm në sistemin AFMIS, zhvilluar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe nga Ministria e Drejtësisë;</li> <li><b>3. Tetor 2020</b> – Workshop mbi rishikimin e metodologjise se PBA-së, zhvilluar nga Projekti i Asistencës teknike të BE-së “Forcimi i Menaxhimit të Financave Publike”, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”;</li> <li><b>4. Nëntor 2020</b> –Pjesëmarrje në takimin e parë konsultativ të Grupit Teknik të Punës për hartimin e Strategjisë</li> </ol>

					Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë; <b>5. Dhjetor 2020</b> – Pjesëmarrje në trajnimin me temë “Përdorimi i Portalit SelfCare dhe fatura elektronike”, zhvilluar në kuadër të procesit të fiskalizimit, zhvilluar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.
<b>1.3.13</b>	-Realizimi i detyrave të ngarkuara sipas nevojave dhe përshkrimit të punës.	-Realizimi i detyrave të ngarkuara sipas nevojave dhe përshkrimit të punës.	Specialisti Financës	Janar-Dhjetor 2020	<p><b>Realizuar</b></p> <p>Gjatë vitit, janë zbatuar të gjitha detyrat dhe janë kryer të gjitha raportimet/dhëniet e informacionit që lidhen me pozicionin dhe të ngarkuara nga Titullari i institucionit, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Hartimi, monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e planit të veprimit për Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë, Strategjinë për Mbrojtjen e të Miturve, si dhe Strategjinë Antikorrupsion;</li> <li>▪ Pjesëmarrja në grupe pune: grupi teknik për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, Faza II; grupi punës për hartimin e ndryshimit të bazës ligjore të KSHB; grupi për inventarizimin/vlerësimin e</li> </ul>

					<p>aktiveve etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kthim përgjigje për shkresat që lidhen me pozicionin e punës, hartim i urdhërave të brendshëm, ndjekja e procedurave për konfirmimin apo anulimin e nëpunësve autorizues të institucionit, kthim përgjigjet në rrugë elektronike, përgatitjen e materialeve për publikim në faqen web të institucionit <a href="http://www.kshb.gov.al">www.kshb.gov.al</a>, si dhe çdo detyrë tjetër e ngarkuar.</li> </ul>
--	--	--	--	--	---

**Përgatiti: Stafi i Komitetit Shqiptar të Birësimeve**